

VENDIM
Nr. 760, datë 7.11.2012

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR PAGESËN E EKSPERTËVE KONTABËL TË LICENCUAR PËR SHËRBIMIN E AUDITIMIT TË FONDEVE TË SUBJEKTEVE ZGJEDHORE, PËR ZGJEDHJET VENDORE TË DATËS 8 MAJ 2011

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, zëri “Mallra e shërbime”, t’i shtohet një fond prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh, për pagesën e ekspertëve kontabël të licencuar për shërbimin e auditimit të fondeve të subjekteve zgjedhore, për zgjedhjet vendore të datës 8 maj 2011.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha